

Reagim publik

Përfaqësimi i zërit dhe vullnetit të komuniteteve Ashkali, Egjiptjan dhe Romë në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

Me 14 Shkurt 2021 janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme për Parlamentin e Kosovës. Komisioni Qendror Zgjedhjeve (KQZ) ka publikuar në K-vote në website rezultatet preliminare për Zgjedhjet e Parakohshme të 14 Shkurtit. Bazuar në rezultatet e paraqitura preliminare, ku nuk përfshihen votat nga diaspora dhe votat me kusht, më posht janë paraqitur rezultatet preliminare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Partit Politike dhe Iniciativa Qytetare që kanë garuar për të përfaqësuar komunitetet Ashkali, Egjiptjan dhe Romë në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

- 3 parti politike dhe 1 Iniciativ Qytetare nga komuniteti Romë kanë garuar dhe kanë fituar 6550 vota dhe fitojn **2 ulëse**.
- 2 parti politike nga komuniteti Egjiptjan kanë garuar dhe kanë fituar 4979 vota dhe fitojn **1 ulëse**.
- 3 parti politike nga komuniteti Ashkali kanë garuar dhe kanë fituar 4858 vota dhe fitojn **1 ulëse**.

Nëse marrim parasysh Regjistrimin e Popullësis në Kosovë të vitit 2011, në Kosovë jetojnë **15436** Ashkali, **11524** Egjiptjan dhe **8824** Romë, në të gjitha zgjedhjet paraprake (përveq në zgjedhjet e vitit 2019), komuniteti Ashkali ka fituar 2 ulëse, komuniteti Egjiptjan 1 ulëse dhe komuniteti Romë 1 ulëse

Egiztojnë disa arsye pse këto Zgjedhje Parlamentare nuk përfaqësojnë zërin dhe vullnetin e komuniteteve Ashkali, Egjiptjan dhe Romë:

1. Duke marr parasysh numrin e banorëve (**8824** Romë), është e pamundur që 4 partit politike të komunitetit Romë ti fitojnë **6551** vota nga komuniteti Romë.
2. Partit Politike të Komunitetit Romë kanë fituar numër të konsideruaeshëm të votave në disa Komuna ku nuk ka fare ose jeton një numër shumë i vogël i komunitetit Romë. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur votat e fituara nga partit politike Rome. Krahasuar me numrin e banorëve, numrin më të madh të votave ka fituar partia politike “Romani Iniciativa”)

Partia	Glogovc	Leposavic	Novobërdë	Prishtinë	Skënderaj	Shtime	Suharekë	Viti	Graçanicë	Ranillug	Partesh	Kllokot	Mitrovicë Veriore	Totali votave
RI	28	244	215	26	13	8	6	0	1620	199	88	147	210	3074
LRPR	11	3	1	14	3	13	29	1	4	1	0	0	3	123
PREBK	5	1	7	100	10	23	28	39	58	1	4	0	5	316
KNRP	4	0	2	49	2	8	18	9	7	1	1	3	2	119
TOTALI votave	48	248	225	189	28	52	81	49	1689	202	93	150	220	3274

Numri i banorëve	0	0	63	56	0	23	41	12	745	0	0	9	0	949
------------------	---	---	----	----	---	----	----	----	-----	---	---	---	---	-----

3. Partit politike në zgjedhjet e kaluara kanë fituar shumë më pak vota krahasuar me zgjedhjet e 14 shkurtit 2021. Në tabelën e mëposhtme janë elaboruar statistikat:

Totali i votave të partive politike Rome në zgjedhjet e vitit 2021 dhe viteve paraprake.	
2021	6550
2019	1367
2017	2150
2014	1287

Konkluzionet:

- Duke marr parasysh statistikat e lartëshënuara, mund të konkludojmë që numri i votave të partive politike Rome nuk është në proporcion me numrin e banorëve të komunitetit Romë;
- Partia politike Rome "Romani Iniciativa" ka fituar numër të konsiderueshëm të votave në Komunitat ku nuk ka fare ose ka shumë pak banorë të komunitetit Romë. Kjo ka ndodhur kryesisht në komunitat të banuara me komunitetin Serb dhe mund të supozohet që përfaqësuesit e kësaj partie politike nuk do të përfaqësojnë zërin dhe vullnetin e komunitetit Romë.
- Komunitetet Ashkali dhe Egjiptjan janë dëmtuar politikisht sepse do të duhej të kishin në total tre (3) deputet duke marr parasysh që numri i banorëve Ashkali dhe Egjiptjan në Kosovë është më i lartë krahasuar me Romët.
- Egziston mundësia që komunitetet Ashkali, Egjiptjan dhe Romë të mos formojnë Grup Parlamentar dhe fuqia e tyre politike do të zbehet. Deputet e këtyre tri komuniteteve nuk do të kanë mundësi të arrijnë të mbojnë interesat e komuniteteve Ashkali, Egjiptjan dhe Romë në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

5. Komuniteti Boshnjak gjendet në situatën e ngjajshme sa i perket mos përfaqësimit të zërit dhe vullnetit të tyre demokratik duke pas parasysh që ka vota të konsiderueshme në komuna ku nuk jeton ky komunitet.

Rekomandimet:

Akterë të ndryshëm (posaqërisht komunitetet Ashkali, Egjiptjan dhe Romë) nuk janë të lumtur me situatën e krijuar duke pas parasysh që nuk po përfaqësohet zëri i dhe vullneti i vërtet demokratik i tyre. Akterë të ndryshëm janë duke kërkuar anulimin e rezultateve në vendvotimet në të cilat nuk përfaqësohet zëri i këtyre tri komuniteteve.

Institucionet e Kosovës dhe Bashkësia Ndërkombëtare në Kosovë, duhet të marrin parasysh brengat dhe rekomandimet e bazuara në analizat e paraqitura nga:

- Partit politike të komuniteteve Ashkali, Egjiptjan dhe tri (3) partive tjera politike Rome;
- Partit Politike të komunitetit Boshnjak;
- Shoqëria Civile;
- Analistë të ndryshëm politik;
- Publikimet e ndryshme në media sociale;
- Storit e ndryshme të televizioneve dhe radiove;
- Brengat e paraqitura nga anëtarët e Komisionit Qëndror Zgjedhor (KQZ);
- Feedbackun e institucioneve të ndryshme Ndërkombëtare;
- Qytetarët e komuniteteve Ashkali, Egjiptjan dhe Romë.

Nëse institucionet e Kosovës dhe Bashkësia Ndërkombëtare në Kosovë nuk ndërmarrin hapa emergjent për të siguruar përfaqësimin parlamentar të bazuar në vullnetin e komuniteteve Ashkali, Egjiptjan dhe Romë (poashtu edhe Boshnjak), komunitetet nuk do të kanë përfaqësues legjitim të përzgjedhur me votën e komuniteteve të tyre.

Nëse nuk veprohet urgjentisht dhe nuk merren parasysh reagimet nga akterë të ndryshëm, manipulimet e votave politike do të vazhdojnë dhe situata do të përkeqësohet edhe në Zgjedhjet e ardhshme Parlamentare, dhe qytetarët e komuniteteve jo-shumicë do të kanë edhe më pak përfaqësues legjitim të përzgjedhur me zërin e tyre.

Mirëpresim reagim urgjent nga institucionet nga akterët e latëpërmendur dhe mediave Kosovare për të siguruar përfaqësimin e zërit dhe vullnetit të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptjan në Parlamentin e Republikës së Kosovës.